

KISHA E SHËN MËRISË NË ARTANË

Emin SALLAHU¹

PËRMBLEDHJE

Qyteti i Artanës, njihet si një nga qytetet më të zhvilluara gjatë mesjetës në rajon dhe më gjerë. Në kuadër të objekteve më reprezentative të kultit të cilat ndodhen në afërsi të kalasë janë dy kisha (katedralja dhe kisha e ashtuquajtur kisha "Saksone"), themi e ashtuquajtura sepse emri i sajë i vërtetë është: "Santa Maria Cieza Canonice", apo e njohur ndryshe në burime si "S. Maria in Dogni Trg". Kisha e Shën Mërisë edhe pse mendohet të jetë e ndërtuar në shekullin e XIV, ka gjasa të jetë ndërtuar edhe më herët, sepse komuniteti i krishterë katolik ishte i pranishëm edhe para shekullit XIV në Artanë. Njëra ndër dokumentet të cilat ofrojnë të dhëna shkencore rreth famullisë romane katolike të Novobërdës mesjetare kah fundi i shekullit XIV dhe fillim shekullit XV, është një letër e papës Urbanit VI drejtuar argjipeshkvit të Kotorrit me 8 shkurt 1381. Me rastin e pushtimit të Artanës nga Osmanët në vitin 1455, edhe kjo kishë u plaçkit dhe u shkatërrua. Për kishën "Saksone" shkruan në relacionet e tij edhe argjipeshkvi i Tivarit Marin Bici në shekullin XVII. Kjo kishë e cila është e ndërtuar me gurë të latuar dhe gjysmë të latuar është e konceptuar sipas tipit të Kuvendit Françeskan dhe Dominikan në Raguzë. Për këtë kishë ka shkruar në shekullin e XVII edhe Gjergj Bardhi. Punimet e para konservuese në këtë kishë janë realizuar në vitin 1954. Pas heqjes së shtresave të krijuara në formë gërmadhe, dolën në pah muret, varret, altari dhe gjetje tjera arkeologjike.

Fjalë kyçe: shqiptaria, albanianizmi, institucioni i familjes, haplotipet, kultura shqiptare, veshja, antropologjia.

HYRJE

Kisha gjendet në 1 km në jug-lindje të kalasë në fshatin Bostan. Kjo kishë edhe pse ndodhet jashtë kompleksit të parë të kalasë megjithatë hyn në kuadër të kompleksit të tërësishëm, së bashku me objektet tjera si kisha, xhamia, tyrbja dhe objektet e banimit në qytetin e Artanës. Kjo kishë mendohet të jetë e ndërtuar në fillim të shekullit të XIV².

1. KISHA E SHËN MËRISË NË ARTANË

Qyteti i Artanës (Novobërdës), njihet si një nga qytetet më të zhvilluara gjatë mesjetës në rajon dhe më gjerë. Objekti kryesor i qytetit të Artanës është pa dyshim kështjella e qytetit, por pasurimin e kësaj tërësie të kompleksi arkeologjik dhe arkitektonik e plotësojnë objektet tjera si ato të kultit edhe ato të banimit. Në kuadër të objekteve më reprezentative të kultit të cilat ndodhen në afërsi të kalasë janë dy kisha (katedralja dhe kisha e ashtuquajtur kisha "Saksone"), themi e ashtuquajtura sepse emri i sajë i vërtetë është: "Santa Maria Cieza Canonice", apo e njohur ndryshe në burime si "S. Maria in Dogni Trg"³. Kisha gjendet në 1 km në jug-lindje të kalasë në fshatin Bostan. Kjo kishë edhe pse ndodhet jashtë kompleksit të parë të kalasë megjithatë hyn në kuadër të kompleksit të tërësishëm, së bashku me objektet tjera si kisha,

¹Ma, Trashëgimi Kulturore/ Turizëm

²V.S. Jovanović. "Novo Brdo-srednjovekovni grad", Novo Brdo, Beograd 2004, 10-161.

³Dinić, Istoriju Rudarstva, II, 92.

xhamia, tyrbja dhe objektet e banimit në qytetin e Artanës. Kjo kishë mendohet të jetë e ndërtuar në fillim të shekullit të XIV⁴.



Fig.-1 - Themelet e kishës Shën Mëria në Artanë

Kisha Saksone edhe pse mendohet të jetë e ndërtuar në shekullin e XIV, ka gjasa të jetë ndërtuar edhe më herët, sepse komuniteti i krishterë katolik ishte i pranishëm edhe para shekullit XIV në Artanë. Sa i përket çështjes së juridiksionit kishtarë Artana (Novobërda) ishte e lidhur me Ipeshkvin e Kotorrit, bile edhe pas ndarjes së Kotorrit nga pjesa e Rashës mesjetare. Kjo dëshmohet nga letra e papës Klementit VI në vitin 1346, nga e cila del se përveç tjerave famullia e Artanës ishte nën juridiksionin e Kotorrit⁵. Më vonë pas rënies së despotatit në vitin 1439, Argjipeshkvia e Tivarit e zëvendësoi atë të Kotorrit në udhëheqjen e famullive të këtyre anëve. Në vitin 1458, papa Piu II, përmend se kisha e Shën Nikollës dhe Shën Mërisë në Artanëi takon Argjipeshkvisë së Tivarit⁶.

Njëra ndër dokumentet të cilat ofrojnë të dhëna shkencore rreth famullisë romane katolike të Novobërdës mesjetare kah fundi i shek. XIV dhe fillim shek. XV, është një letër e papës Urbanit VI drejtuar argjipeshkvit të Kotorrit me 8 shkurt 1381. Kjo letër e cila ndodhet në Arkivin e HAZU të Zagrebit është publikuar së fundmi edhe nga studiuesi Miljan Gogić.⁷ Kjo letër paraqet mbështetjen e papës Urban VI për rektorin/ famullitarin e kishës së Shën Mërisë, që kisha e sapo ngritur e Shën Nikollës në Kalanë e Artanës (Novobërdës) ti nënshtrohej në aspektin administrativ dioqezës së Kotorrit. Për një kohë kisha e Shën Mërisë ka qenë tempulli i vetëm i komunitetit katolik të Novobërdës dhe si e tillë paraqiste interes të veçantë për Kishën Katolike Romake. Kisha e Shën Marisë ishte vendosur jashtë fortifikimeve në tregun e poshtëm siç thuhet qartë në burime (Santa Maria in Novomonte di Dogni Targ), në një distancë sipas letrës së papës Urbani VI, rreth dy milje larg fortifikatës mbetjet e të cilave duken qartë edhe sot. Kjo kishë është e njohur edhe si kisha Saksone në fshatin Bostan.

⁴V.S.Jovanović. "Novo Brdo-srednjovekovni grad", Novo Brdo, Beograd 2004,10-161.

⁵ Po aty, pg. 468

⁶ Po aty,pg. 468

⁷ Po aty, pg. 469

Ndryshe nga kisha e Shën Mërisë ku donatorë ishin minatorët Sakson, ndërtuesit e kishës së Shën Nikollës në fortifikatë ishin kottorrasit, të cilët e ndërtuan besohet mes dekadës së tetë të shek.XIV.Kishën e Shën Nikollës brenda fortifikatës letra në fjalë e quan kapellë(kishës), ajo sigurisht ishte me përmasa më të vogla, në një hapësirë të kufizuar brenda mureve të qytetit.⁸Kisha e Shën Mërisë kishte rektorin e vet, p.sh rektori Nikolaus de Vico bëri një korrespondencë me Selinë Apostolike, ku kërkoi që kishëza e re (Shën Nikolla) për arsye senuk kishte të ardhura të mjaftueshme duhej ti bashkohejkishës(Shën Mërisë) në të cilën ishte ai rektor.Në anën tjetër vet papa në një letër të ipeshkvit të Kotorrit, pranon se nuk ka informata të mjaftueshme dhe se mbështet përpjekjet e rektorit të Shën Mërisë.Në fund të kësaj letrë përpos tjerash papa thekson se çdo veprim që do të ishte në kundërshtim me letrën do të konsiderohej e papranueshme, duke i bërë thirrje ipeshkvit të Kotorrit që të veprojë sipas udhëzimeve.⁹Letra e papës u regjistrua më 15 shtator 1383 në Kotorr.

Me rastin e sulmeve nga Osmanët dhe pushtimin e Artanës në vitin 1455, sikur se disa objekte tjera edhe kjo kishë u plaçkit dhe u shkatërrua.Tani kjo kishë e cila njihet më shumë si "Kisha Sase" për arsye se përreth sajë përveç arbërorëve vendas jetonin edhe Saksonët(fis gjerman) të njohur si mjeshtër të minierave dhe përpunimit të xeheve si dhe elementi apo arsyeja kryesore ndoshta sepse ishin donatorë të ngritjes apo ndërtimit të kësaj kishe (Shën Marisë). Për kishën "Saksone" shkruan në relacionet e tij edhe argjipeshkvi i Tivarit Marin Bici në shek. XVII,sipas tij "një gjysmë milje larg që andej, është një kishë tjetër e bukur dhe e madhe, me titullin e Zonjës Mëri, e aftë për 3000 vetë dhe me një hajat të bukur e të madh të stolisur me piktura të bukura..."¹⁰

Kjo kishë e cila është e ndërtuar me gurë të latuar dhe gjysmë të latuar dhe është e konceptuar sipas tipit të Kuvendit Françeskan dhe Kuvendit Dominikan në Raguzë (Dubrovnik).Kisha Sase dhe Katedralja e Artanës janë dy kishat më madhështore në këtë lokalitet, këtë e vërteton edhe relatori i më vonshëm Gjergj Bardhi në vitet 1641 – 1642¹¹. Kisha e "ShënMërisë" ka ende gjurmë të themeleve dhe mureve , në të cilat ka pas edhe intervenime të cilat do ti paraqesim në vijim:

1.1 INTERVENIMET KONSERVUESE NË VITIN 1954

Gërmimet e para hulumtuese në kishën e Shën Mërisë urealizuan në vitin 1954.Qëllimi i punimeve në këtë vit ishte identifikimi i objektit si dhe parapërgatitja e një aktiviteti i cili do të pasojë në vitet në vijim.Në fillim sipas burimeve historike të deri atëhershme mendohej se në Artanë kishte numër të vogël të kishave (dy –tre sish), por më vonë u kuptua se ka mbi dhjetë kisha dhe se hulumtimet e mëvonshme do ti nxjerrin në pah këto objekte.

Kisha Saksone apo "ShënMëria" pa dyshim është ndër më të rëndësishmet, andaj këtë vit u ndërmorën masat e para , apo punimet e para. Pas heqjes së shtresave të krijuara në formë

⁸ Po aty, pg. 470-471


⁹ Po aty, pg. 473

¹⁰ "L'è lontano à mezzo....Zamputi, Relazione I, 175; Diniq, Istoriu rudarstve knj.I, 27; II, 95.

¹¹Gjon Berisha , Arbërorët, Ndërmjet kishës Perendimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV, pg, 467

gërmadhe, dolën në pah muret në lartësi 1.5m, trashësi 85cm deri 1m, si dhe varret dhe altari¹².


Në vazhdim të punimeve u gjetën edhe shtresa të pikturave murale të cilat ishin të koncentruar te altari e që besohet se i takojnë fundit të shekullit të XIV apo ndoshta fillimit të shekullit XVsi gjetje të artefakteve të ndryshme. Gjetjet kryesore janë një kthinë në këndin e sakristisë, ku u gjetën pjesë argjendi dhe rreth 150 aspri (monedha argjendi) të Sylejman të I-rë e që datojnë nga viti 1510, pastaj dy unaza argjendi si dhe gjetje tjera punimesh të futura në një qese nga lëkura. Gjetje tjetër e rëndësishme është një unazë nga argjendi, e cila kishte bazamentin për guri i cili nuk u gjet. Kjo unazë u gjet nën bazën e sakristisë në 130 cm thellësi. Kjo kishë ishte e mbushur me varre si brenda dhe jashtë sajë, pastaj kishte edhe objekte përcjellëse si dhe bunarin në kompleksin e vet. Ky objekt paraqet një objekt shumë të rëndësishëm të komunitetit të krishterë katolik të Artanës mesjetare si vendësit arbërorët, saksonët, raguzanët, kotorrasit etj.¹³ Në vazhdim do të paraqesim disa nga gjetjet në vitin 1954.¹⁴



Сл. 11. Прстѣн, инв. бр. 11, Музеј у Приштини

Fig. 11. Ring, inv. no. 11, Priština Museum

Fig. 2. - Unazë ari (i mungon guri)



Сл. 15. Прстѣн, инв. бр. 4601, Народни музеј, Београд; Прстѣн, инв. бр. 2, Музеј у Приштини


Fig. 15. Ring, inv. no. 4601, Narodni Muzej, Belgrade. Ring, inv. no. 2, Priština Museum

Fig. 3. Varri nr 10, unaza argjendi

¹²Starinar, *Organ Arheološkog Instituta, Beograd*, 1958 pg, 338-339

¹³ Emil Čerškov, *Starinar, Organ Arheološkog Instituta, knjiga VII-VII/ 1956-1957, Beograd* 1958, pg, 340

¹⁴ Emina Zečević, *Nakit Novog Brda. Novo Brdo, Beograd* 2004, pg, 196, 197, 200, 2001



Сл. 1. Прстѣн, инв. бр. 1, Музеј у Приштини
Fig. 1. Ring, inv. no 1, Priština Museum



Сл. 19. Пар наушница, инв. бр. 3645, Народни музеј, Београд
Fig. 19. Pair of earrings, inv. no. 3645, Narodni Muzej, Belgrade



Сл. 1. Унутрашњост цркве са гробовима и олтаром. — Fig. 1. Intérieur de l'église avec les tombes et l'autel

Fig. 6. Brendia e kishës, varret dhe altari




Сл. 2. Детал са олтара и гробнице са алкама. — Fig. 2. Détail de l'autel et tombe avec anneaux

Fig. 7. Detaj i altarit dhe varreve me unaza

1.2 KONSERVIMI I THEMELEVE TË KISHËS NË VITIN 1955

Hulumtimet arkeologjike në Artanë vazhduan edhe në vitin 1955, nga 15 korrik deri më 15 gusht nën udhëheqjen e arkeologut Dragolub Jovanović në pjesën e parë dhe pjesën e dytë nga arkeologu Ivan Zdravković. Kuptohet punimet ishin të përqendruara si në kala poashtu edhe në

kishën e Shën Mërisë. Këtë vit janë kryer shumë punë hulumtuese dhe janë realizuar gjithashtu punën konservuese dhe restauruese të kësaj kishe të rëndësishme. Në vazhdim do të paraqesim materialin grafik dhe fotografik të realizimit të punimeve në kishën e “Shën Mërisë” apo e njohur si kisha Sase:



Сл. 1. Сашка црква, општи изглед цркве у току конзерваторских радова. — Fig. 1. L'église de Saš, aspect général de l'église au cours des travaux de conservation

Fig. - 8 - Kisha e Shën Mërisë, pamje e përgjithshme gjatë punimeve konservuese -1955




Fig. 9. Skicimi i bazës së kishës Shën Mëria



Fig. 10. Muret dhe bazament shtyllë



Fig. 11. Absida gjatë konservimit




Fig. 12. Dritare e stilit gotik




Fig. 13. Hyrja perëndimore në kishën Sase, baza



Сл. 11 Сашка црква, ужи део цркве после извршених конзерваторских радова. — Fig. 11. L'église de Sas, la partie plus étroite de l'église après les travaux de conservation

Fig. 14. Kisha e "Shën Mërisë" apo kisha Saksone, pas intervenimeve konservuese dhe restauruese

Kjo kishë e cila për fat të keq sot gjendet në një gjendje shumë të keqe, paraqet njërën nga objektet kryesore të popullatës të besimit katolik të Novobërdës- Artanës. Në njërën anë dëshmon për përkatësinë fetare të shumicës e që ishte katolike, ndërsa në anën tjetër paraqet luftën ose përpjekjet

për ta ruajtur lidhjen burimore me qendrat katolike bregdetare si Raguzën, Tivarin, Kotorrin, Shkupin etj si dhe me qendrën kryesore me Vatikanin apo papën. Dëshmi për këto përpjekjet janë edhe relacionet e cekura në fillim të shkrimit. Si karakteristikë e veçantë e kësaj kishe është ajo që e kemi cekur më lartë nuk është vetëm përkatësia fetare e vendasve, pastaj edhe tregtarëve zanatlinjë mjeshtërve e posaçërisht donatorëve (Saksonëve), por edhe përkushtimi i tyre që me mjete ta përkrahin ndërtimin, mirëmbajtjen dhe ekzistimin e kësaj kishe pastaj katedrales por edhe kishave dhe objekteve tjera në Artanë, duke iu kundërvu tentativave për dominimin e kishës ortodokse me qendër Kostandinopojën si dhe despotëve bizantin të kohës.

Duke pas parasysh rëndësinë e kësaj kishe si trashëgimi arkitekturore, arkeologjike dhe fetare, nevoja për intervenime është e domosdoshme. Në të kundërtën nga faktori kohë e herë pas here edhe faktori njeri kemi frikë se ky objekt si dhe shumë tjera mund të përfundojnë në harrese dhe të mbesin vetëm si kujtim nga e kaluara.



Fig.14, 15, 16. Gjendja e tanishme e kishës Shën Mëria

2. PËRFUNDIME

- Duke patur parasysh rëndësinë e kësaj kishe si trashëgimi arkitekturore, arkeologjike dhe fetare, nevoja për intervenime është e domosdoshme. Në të kundërtën nga faktori

kohë e herë pas here edhe faktori njeri kemi frikë se ky objekt si dhe shumë tjera mund të përfundojnë në harresë dhe të mbesin vetëm si kujtim nga e kaluara.

3. STUDIME MBËSHTETËSE

1. Emil Čerškov, *Starinar, Organ Arheološkog Instituta, knjiga VII-VII/ 1956-1957, Beograd 1958, pg, 340.*
2. Emina Zečević, *Nakit Novog Brda. Novo Brdo, Beograd 2004, pg, 196, 197, 200, 2001.*
3. "Là lontano à mezzo....Zamputi, *Relacione I, 175; Diniq, Istoriu rudarstve knj.I, 27; II, 95.*
4. Gjon Berisha, *Arbërorët, Ndërmjet kishës Perendimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV, pg, 467*
5. *Starinar, Organ Arheološkog Instituta, Beograd, 1958 pg, 338-339.*
6. Dinić, *Istoriju Rudarstva, II, 92.*
7. V.S.Jovanović. "Novo Brdo-srednjovekovni grad", *Novo Brdo, Beograd 2004, 10-161.*

